

RAPORTI I *monitorimit* PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 2

(periudha e raportimit:
shkurt-prill 2017)

Shkup, Maj 2017

Projekti:

Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



British Embassy
Skopje

Hartimi i këtij publikimi është në kuadër të Projektit “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë”, i mbështetur nga Ambasada e Britanisë, Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë publikim i pasqyrojnë opinionet dhe qëndrimet e autorëve.

Përmbajtja

Hyrja.....	4
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM.....	5
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë.....	5
Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë	6
Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve.....	6
Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	8
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KGJRM	8
Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve	8
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave	8
Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave	9
Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë	9
Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve.....	10
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT	10
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë	10
Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë	11
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FAKTEVE	11
Diskutim për iniciativat e parashtruara	11
Procedura sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve	11

Hyrje

E drejta e qytetarit që të gjykohet nga gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm është postulat kryesor i pushtetit gjyqësor. Pavarësia dhe paanshmëria janë vlera të pushtetit gjyqësor të garantuara me Kushtetutën e RM-së, me ligjet dhe me dokumentet e ratifikuara ndërkombëtare. Këshilli Gjyqësor i RM-së është formuar si organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i gjyqësorit, i cili ka një rëndësi të madhe për sigurimin dhe garantimin e pushtetit gjyqësor të mëvetësishëm dhe të pavarur përmes realizimit të funksioneve të veta. Në sistemin e jurisprudencës së RM-së, nga viti 2015 krahas Këshillit Gjyqësor, ekziston edhe Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve) tek i cili qytetarët mund të paraqesin parashtrësia në lidhje me parregullsitë e punës së gjyqtarëve, të kryetarëve të gjykatave ose për prolongimin e stërzgjatur të procedurave gjyqësore.

Instituti për të Drejtat e Njeriut e implementon Projektin: “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM”, në periudhën nga muaji shtator 2016, deri në muajin mars 2018, i cili mbështetet nga Ambasada e Britanisë në Shkup.¹

Ky është **raporti i dytë monitorues** në kuadër të Projektit, i cili e përfshin periudhën nga muaji shkurt deri në muajin prill 2017. Raporti i monitorimit për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit është hartuar në bazë të Matricës-Monitoruese me indikatorë të përcaktuar.²

1 Më shumë informacione për aktivitetet e Projektit janë të aksesshme në internet faqen e Institutit për të Drejtat e Njeriut - www.ihr.org.mk, si dhe përmes aplikacionit mobil “Këshilli Gjyqësor nën thjerrëz” i aksesshëm në Google Play dhe Apple Store.

2 Metodologjia e monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, E aksesshme në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=182>.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

√ = e plotësuar
 × = e pa plotësuar
 √ × = pjesërisht e plotësuar

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor					
Karakteristika të përgjithshme	I qartë	I lehtë për navigacion	Ka përplot të dhëna relevante	I sistematizuar	I thjeshtë për kërkim
Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të RM-së www.ssrn.com.mk është zëvendësuar plotësisht me ueb-faqen e re www.sud.mk e cila e paraqet formën e integruar të gjyqësorit	√	x	√x	√x	x
Akte të cilat publikohen	Publiki-mi në kohë	Arkiv i aksesshëm (i lehtë për përdorim dhe kërkim)	Azhurnimi i të dhënave	Akte/të dhëna të publikuara të plota	Vërejtje të përgjithshme
Vendime	√	x	√	X√	Vendime për zgjedhje, shkarkim dhe ngjashëm publikohen në ueb-faqen, por të njëjtat janë vështirë të aksesshme, meqë publikimet më të reja janë në faqen e fundit, ndërsa ato më të vjetrat janë në fillim.
Procesverbale	x	X	x	X	Procesverbalet e mbledhjeve nuk publikohen
Komunikata për mbledhjet e konvokuara	√x	√	√	√x	Komunikatat për 3 mbledhje të konvokuara nuk u publikuan në kohë, përkatësisht u publikuan para fillimit të mbledhjes. Për mbledhjet e tjera kishte publikime të rregullta në internet faqen e re www.sud.mk
Prokurime publike, informacione për publikun	√x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor e ka azhurnuar listën e prokurimeve publike për vitin 2016. Lista është e aksesshme vetëm në pjesën "risi".
Raporte vjetore të Këshillit Gjyqësor	x	x√	x	x	Këshilli Gjyqësor i RM-së nuk e ka publikuar Raportin për punën e tyre për vitin 2016. Këshilli Gjyqësor e ka publikuar Raportin për punën e gjykatave për vitin 2016.
Raporte tremujore për punën e gjykatave në RM	x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor rregullisht, në çdo tre muaj, i përpilon raportet tremujore megjithatë, të njëjtat nuk janë të aksesshme në faqen e internetit, edhe pse është e siguruar fusha për këtë dedikim.

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë			
	A posedon KGJRM rregulla për komunikim me publikun		A ka person të angazhuar për t'iu përgjigjur kërkesave konform qasjes së lirë deri te informacionet
	√		√
Informimi proaktiv i publikut	Të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor	Publikime të shpeshtuara	Vërejtje të përgjithshme
Pres-konferenca	x	x	Në këtë periudhë Këshilli Gjyqësor nuk ka mbajtur pres-konferenca
Komunikata	√x	1 herë në javë	Komunikatat më së shpeshti kanë të bëjnë me mbajtjen e mbledhjeve
Intervista	x	1-2	Kryetari i Këshillit Gjyqësor në këtë periudhë ishte i pranishëm në një debat televiziv.
Deklarata	x	1 herë në javë	Si praktikë e sapo inkorporuar që pas mbledhjeve, nëse ka gazetarë, kryetari i KGJRM të jap deklarata dhe t'iu përgjigjet pyetjeve të gazetarëve.

Internet-faqja e mëparshme e Këshillit Gjyqësor të RM-së www.ssrn.mk pushoi së funksionuari. Informacionet publikohen në faqen e re të internetit www.sud.mk e cila është ueb-platforma e integruar e re e të gjitha gjykatave dhe e Këshillit Gjyqësor të RM-së. Kjo ueb-faqe është e qartë dhe i përmban të gjitha fushat e nevojshme. Megjithatë, shumë fusha nuk janë plotësuar me informacione dhe të gjitha pjesët nuk azhurohen rregullisht. Navigacioni nga njëra fushë në tjetrën është vështirësuar.

Këshilli Gjyqësor me vonesë publikoi 3 komunikata për mbajtjen e mbledhjeve të hapura. Komunikatat u publikuan para fillimit të mbledhjes, ndërsa komunikatat për konkluzione nga mbledhjet e mbajtura azhurohen rregullisht në faqen e internetit që në ditën e njëjtë. Megjithatë, komunikatat nuk përmbajnë informacione të detajuara për mbledhjen, por theksohen vetëm pikat e rendit të ditës për të cilat është votuar.

Fushat për raportet tremujore për punën e gjykatave, prokurimeve publike, si dhe për informacionet për publikun nuk plotësohen fare. Tabela me prokurime publike për vitin 2016 është azhurnuar në muajin shkurt, por është e aksesshme vetëm në pjesën "risi".

Këshilli Gjyqësor i RM-së nuk e publikon programin e punës, strategjitë, qëndrimet, opinionet, studimet, si dhe dokumentet e tjera të ngjashme.

Transparencë dhe llogaridhënie e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve

Transparencë dhe llogaridhënie e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve			
Transparenca e mbledhjeve	Numri i mbledhjeve të mbajtura	Pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë objekt diskutimi	Rrethanat në të cilat është përjashtuar publiku
Shkurt	3	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së Punës të Këshillit Gjyqësor të RM-së Shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e katërt të vitit 2016.	/

Mars	2	<p>Shqyrtimi i dorëheqjes së ushtruesit të detyrës-kryetar i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup.</p> <p>Vendim për përcaktimin e Ushtruesit të detyrës – kryetar i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup.</p> <p>Miratimi i rank-listave përfundimtare të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.</p> <p>Miratimi i Vendimit për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë sipas vendimit nr.08-1586/2 nga data 7.10.2016.</p>	/
Prill	3	<p>Miratimi i Vendimit për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup.</p> <p>Formimi i komisioneve nga radhët e anëtarëve të KGJRM për vlerësimin e rregullt të punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në Republikën e Maqedonisë, për vitin 2015 dhe 2016.</p> <p>Miratimi i Vendimit për përcaktimin e numrit të përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor në gjykatat themelore, në gjykatat e apelit, në Gjykatën Administrative, në Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë.</p> <p>Shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve vjetore për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016.</p> <p>Shqyrtimi i Raportit vjetor të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë për qëndrimet parimisht të përcaktuara dhe për opinionet parimore juridike për çështje të rëndësishme për sigurimin e zbatimit të unifikuar të ligjeve nga ana e gjykatave.</p>	

Në periudhën kohore, nga muaji shkurt deri në muajin prill të vitit 2017, Këshilli Gjyqësor mbajti gjithsej 8 mbledhje. Të gjitha pikat e rendit të ditës në mbledhjet e Këshillit Gjyqësor në këto tre muaj ishin të hapura për publikun. Megjithatë, për një numër të madh të pikave të rendit të ditës nuk zhvillohet diskutim esencial, por vetëm votohet. Për shembull, gjatë zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Supreme të RM-së kandidatët ishin të ndarë në tre grupe, sipas kriterëve të ndryshme, kanë pasur vlerësime të ndryshme, meqë janë vlerësuar në baza të ndryshme, përkatësisht si gjyqtarë në gjykata të ndryshme dhe si kryetarë të gjykatave. Propozimi për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të RM-së u hodh në votim, pa pasur diskutim paraprak për kandidatin e propozuar dhe për arsyet e zgjedhjes së tij.

Ndryshime dhe plotësime të Rregullores së Punës së KGJRM – Në mbledhjen në të cilën u miratuan ndryshimet dhe plotësimet **nuk kishte diskutime në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara nga ana e anëtarëve të KGJRM, të cilët ishin të pranishëm në mbledhje.** Në mesin e korigjimeve dhe harmonizimeve tjera teknike me ndryshimet ekzistuese ligjore mund të theksohen ndryshimet dhe plotësimet që kanë të bëjnë me **rritjen e mundësisë për vlerësim të jashtëzakonshëm**, jo vetëm të gjyqtarëve gjatë zgjedhjes në gjykatë më të lartë, siç ishte deri më tani, por këtë mundësi Këshilli Gjyqësor do ta ketë edhe gjatë zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, si dhe sipas kërkesës së Këshillit të Fakteve. Në dhjetor të vitit 2016 KGJRM tanimë e bëri vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të gjykatave, kur një mbështetje të këtillë në dispozitat e Rregullores akoma nuk kishte. Këto ndryshime, mes tjerash, e inkorporuan edhe **zgjerimin e mënyrës sipas së cilës do të vendosin për përjashtimin e publikut.**

Në lidhje me raportet vjetore për punën e gjykatave për vitin 2016 në mbledhje u diskutua për parametrat sipas të cilave bëhet vlerësimi i punës së gjykatave. U konstatua se numri më i madh i madh i gjykatave në vitin 2016 janë azhurnuar, megjithatë tek të gjitha gjykatat, në masë më të madhe ose më të vogël, paraqiten probleme të njëjta të cilat në njëfarë mënyre reflektohen mbi azhurnitetin dhe efikasitetin e gjykatave, ndërkaq kanë të bëjnë me probleme hapësinore, pajisje të vjetruar TIK, mospasje numër të mjaftueshëm të nëpunësve administrativë dhe profesionistë gjyqësorë, ndërsa në disa gjykata edhe mospasje të numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve. Në nivel të kënaqshëm është zgjidhja e lëndëve të vjetra dhe ka tendencë për reduktimin e prurjes së lëndëve në gjykata. Mossigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare nga ana e shtetit për buxhetin gjyqësor ka ndikim të madh në punën e suksesshme të gjykatave. Si gjykata joazhurne janë: Gjykata Supreme e RM-së, Gjykata Themelore Kërçovë, Gjykata Themelore Tetovë, Gjykata Themelore Kumanovë, Gjykata Themelore Negotinë, Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup, Gjykata Themelore Berovë, Gjykata Themelore Vinicë, Gjykata Themelore Dellçevë, Gjykata Themelore Koçani. Gjykatat e tjera janë azhurne.

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	
Raporte vjetore	Në përputhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së, Këshilli Gjyqësor harton Raport vjetor për punën e vet. Këshilli Gjyqësor duhet ta paraqes Raportin në Kuvendin e RM-së për shqyrtim dhe miratim. Këshilli Gjyqësor Raportin duhet ta dërgojë të gjitha gjykatave në RM. Raporti duhet të jetë publik.

Këshilli Gjyqësor akoma nuk e ka paraqitur Raportin e punës për vitin 2016 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Raporti për vitin 2016, nga ana e Këshillit Gjyqësor duhet të ishte i hartuar deri në muajin mars të vitit 2017.

EFEKTIVITETI NË PUNËN E KGJRM

Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor e përcakton numrin e vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë, duke e marrë parasysh numrin e përgjithshëm të vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore, si dhe projektin për nevojën e vendeve të cilat do të plotësohen pas përfundimit të trajnimit fillestar.

Këshilli zgjedh gjyqtarë të gjykatës themelore nga rank-lista e kandidatëve të paraqitur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të cilët janë paraqitur në konkurs.

Në këtë periudhë nuk ka zgjedhje të gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe në ato më të larta.

Zbatimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Zbatimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave	
Zgjedhja:	
Lista e kriterëve	<ol style="list-style-type: none"> Kryetari i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në kushte, në procedurë dhe në mënyrë ashtu siç bëhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën përkatëse. Evalrimi i programit të punës së kandidatit për kryetar (Kandidati për kryetar të gjykatës, fletë-aplikimit dhe dokumenteve të tjera ia bashkëngjit programin e punës për mandatin e tij).
Vërejtje të përgjithshme	<p>Në këtë periudhë është bërë zgjedhja e kryetarit të Gjykatës Supreme të RM-së dhe është përcaktuar ushtruesi i detyrës – kryetar i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup.</p> <p>Është hapur konkurs për zgjedhjen e kryetarit të GJTH Shën Nikollë.</p>

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave nga KGJRM	
	Numri i procedurave
Shkurt-prill 2017	/
Vërejtje të përgjithshme	Në këtë periudhë kohore nuk ka të dhëna për shkarkimin e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.

Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë

Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë	
Numri i konkurseve	
Numri i gjyqtarëve-porotë	Në përputhje me Vendimin e KGJRM për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve-porotë në të gjitha gjykatat, për vitin 2015, janë parashikuar 1173 gjyqtarë-porotë
Numri i kandidatëve të paraqitur për gjyqtarë-porotë në periudhën kohore (shkurt-prill 2017)	Zgjedhje të gjyqtarëve-porotë ka pasur në: Gjykatën Themelore Tetovë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 24, prej të cilëve janë zgjedhur 20), Gjykatën Themelore Strumicë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 25, prej të cilëve janë zgjedhur 7), Gjykatën Themelore Manastir (të paraqitur kanë qenë 20, prej të cilëve janë zgjedhur 8), Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup (të paraqitur në konkurs kanë qenë 7, prej të cilëve janë zgjedhur 5), Gjykatën Themelore Koçani (të paraqitur në konkurs kanë qenë 9, prej të cilëve janë zgjedhur 9), Gjykatën Themelore Kriva Pallankë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 4, prej të cilëve janë zgjedhur 3), Gjykatën Themelore Kratovë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 4, prej të cilëve janë zgjedhur 3), Gjykatën e Apelit Shkup (të paraqitur në konkurs kanë qenë 21 kandidatë, prej të cilëve janë zgjedhur 13), Gjykatën Themelore Resnjë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 5, prej të cilëve janë zgjedhur 5), Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup (të paraqitur në konkurs kanë qenë 3, prej të cilëve janë zgjedhur 3), Gjykatën Themelore Kumanovë (të paraqitur në konkurs kanë qenë 10, prej të cilëve janë zgjedhur 9).
Vërejtje të përgjithshme	Në këtë periudhë Këshilli Gjyqësor disa herë konstatoi zgjedhje dhe ndërprerje të funksionit të gjyqtarit-porotë në më shumë gjykata të shtetit. Si problem kryesor gjatë çdo zgjedhje konstatohet mungesa e gjyqtarëve-porotë dhe numri i pamjaftueshëm i kandidatëve të cilët paraqiten në konkurse për zgjedhjen e gjyqtarit-porotë.

Kriteri për zgjedhjen e kandidatit për gjyqtar-porotë është të ketë kryer **arsim të lartë**, të gëzoj **reputacion** për ushtrimin e këtij funksioni dhe **të mos ketë më shumë se 64 vjet**. Gjyqtari-porotë për gjykimin e të miturve zgjidhet nga radhët e personave me përvojë në procesin edukativ dhe arsimor të të rinjve. Gjyqtarët-porotë kanë **të drejtë kompensimi** për ushtrimin e punëve të gjyqtarit-porotë e që është në lartësi prej 250 denarë për një ditë. Gjyqtari-porotë zgjidhet për një periudhë kohore **katër vjeçare** me të drejtë për rizgjedhje.

Këshilli Gjyqësor, në periudhën e kaluar, kishte një rol proaktiv në drejtim të rritjes së pagave të gjyqtarëve-porotë përmes kërkesës adresuar ministrit të Drejtësisë, i cili konform Ligjit për gjykatat, miraton akte normative për kompensimet e gjyqtarëve-porotë. Një kërkesë-shkresë për këtë çështje, ministrit të Drejtësisë i ka dërguar edhe Gjykata Supreme, si dhe Gjykata Themelore Shkup 2 për zgjidhjen e këtij problemi. Disa anëtarë të Këshillit Gjyqësor theksojnë se duhet të kenë qasje serioze për zgjidhjen e këtij problemi, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve	
Numri i gjyqtarëve të transferuar përkohësisht	Numri i gjyqtarëve të transferuar përkohësisht jo më gjatë se 1 vit
	Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve nga 2 gjykata
Sa nga transferimet e përkohshme kanë qenë kundër vullnetit të gjyqtarit	/
Vërejtje të përgjithshme	Në këtë periudhë kohore u bë transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Koçani në Gjykatën Themelore Dellçevë, sipas pëlqimit paraprak nga kryetarët e gjykatave dhe nga gjyqtari i cili transferohet përkohësisht deri në 1 vit. Duhet të theksohet kërkesa e kryetares së Gjykatës së Apelit Shkup për delegimin e gjyqtarëve nga gjykatat e tjera të apelit për zgjidhjen e lëndëve të prapambetura që i ka kjo gjykatë. Për shkak të vëllimit të punëve në të gjitha gjykatat e apelit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve nga gjykatat e tjera të apelit në Gjykatën e Apelit Shkup bëhet vetëm për tre muaj.

Rekomandime për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet të Këshillit Gjyqësor:

Rekomandohet portali www.sud.mk, në pjesën për Këshillit Gjyqësor të RM-së të plotësohet në të gjitha fushat me informacione relevante të cilat do të jenë lehtë të aksesshme. Dokumentet të radhiten sipas datës së publikimit.

Këshillit Gjyqësor i RM-së në të ardhmen duhet të ketë një rol akoma më të madh proaktiv në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit. Ai nuk duhet vetëm t'i implementoj ligjet, por atij duhet t'i sigurohet një rol më i madh në krijimin e politikave për një gjyqësor funksional, të pavarur dhe të paanshëm.

Këshilli Gjyqësor duhet të kujdeset që gjyqtari, i cili zgjidhet në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës, të promovojë standarde të larta të sjelljes së gjyqtarit, me qëllim që të fuqizohet besimi i opinionit publik ndaj gjyqësorit, e që është një element esencial për sigurimin e gjyqësorit të pavarur. Kjo ka rëndësi të veçantë meqë në raportet e tij vjetore Këshilli Gjyqësor në mënyrë eksplicite thekson se do të angazhohet për një sistem bashkëkohor dhe transparent gjyqësor, me qëllim që ta rris besimin e qytetarëve dhe të mundësoj qasje më të lehtë dhe më efikase deri te drejtësia.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve

Këshilli i Fakteve **nuk ka ueb-faqe të vet**, meqë Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk ka zbatuar prokurim përkatës për një gjë të këtillë, ndërkaq as komunikatat nuk i publikon përmes ndonjë medie tjetër. Këshilli i Fakteve raportet e punës së vet përmes postës elektronike ua dërgon mediave dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut.

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë		
Karakteristika të përgjithshme për transparencën e institucionit	A posedon Këshilli i Fakteve rregulla për komunikim me publikun?	A ka angazhuar person për t'iu përgjigjur kërkesave konform qasjes së lirë deri te informacionet?
	√	√
Informimi proaktiv i publikut	Akte/të dhëna të publikuara të plota	Vërejtje të përgjithshme
Pres-konferenca	×	Këshilli i Fakteve, në këtë periudhë kohore, nuk ka mbajtur pres-konferencë për ta informuar publikun.
Komunikata	√	Këshilli i Fakteve ka dërguar komunikata për publikun përmes mediave.
Intervista dhe deklarata për media	√x	Kryetari i Këshillit të Fakteve përmes komunikatave komunikoi me publikun.

Raporti vjetor për punën e Këshillit të Fakteve për vitin 2016, u miratua më datë 31.1.2017, në afatin e parashikuar ligjor. I njëjti u është dërguar të gjitha mediave për njoftimin e tyre, si dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut më datë 7.3.2017.

EFEKTIVITETI NË PUNËN E KËSHILLIT TË FAKTEVE

Diskutim për iniciativa të paraqitura

Diskutim për iniciativa të paraqitura

Edhe pse sipas Ligjit, mbledhjet e Këshillit të Fakteve janë të hapura për publikun, publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit, me qëllim të ruajtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar. Megjithatë, në praktikë **mbledhjet janë të fshehta**, meqë edhe sipas Rregullores së Punës, procedura për ngritjen e përgjegjësive të gjyqtarit nuk është publike.

Procedura sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve

Procedura sipas të iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve			
	Shkurt	Mars	Prill
Numri i parashtrësive të paraqitura nga qytetarët, personat juridikë në nivel mujor	54	53	25
Mbledhje të mbajtura të Këshillit të Fakteve në të cilat është diskutuar për parashtrësia të paraqitura	7	10	6
Kërkesa për ngritjen e përgjegjësive të gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor i RM-së	Në muajin prill është paraqitur një kërkesë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor i R. të Maqedonisë		
	Shkurt	Mars	Prill
Aktivitete sipas zërit të dëgjuar	1 (në prill)		

	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3
Kërkesa për ngritjen e përgjegjësisë sipas të dhënave nga zëri i dëgjuar	Kërkesa e paraqitur deri te Këshilli Gjyqësor i RM-së në muajin prill është sipas zërit të dëgjuar.		
Vërejtje të përgjithshme			

Meqë Këshilli i Fakteve nuk ka ueb-faqe të vet, Këshilli i Fakteve e paraqiti raportin tremujor për punën e vet, për periudhën kohore janar-mars 2017 deri te Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe deri te mediat. Për muajin prill IDNJ paraqiti kërkesë për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik në lidhje me numrin e parashtrave-iniciativave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe personave juridikë. Përgjigjen me informacione i pranuar në kohë, dhe të njëjtat janë prezantuar në tabelën më lartë.

Rekomandime për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet të Këshillit të Fakteve:

Nevojitet që Këshilli i Fakteve të ketë internet-faqe të vet në të cilën do t'i publikoj aktivitetet e veta. Është e dobishme që Këshilli i Fakteve të përfshihet në platformën e përbashkët të re të gjyqësorit www.sud.mk. Këshilli i Fakteve aktualisht, si një organ i rëndësishëm për pavarësinë e gjyqësorit i cili inicion procedura për përcaktimin përgjegjësisë së gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës, nuk guxon të anashkalohet nga kjo platformë e internetit. Në ueb-platformën e re qytetarët duhet të njoftohen me mundësinë se si të paraqesin parashtrava për përgjegjësinë e gjyqtarëve deri te Këshilli i Fakteve, si dhe për mënyrën se si mund të paraqiten të njëjtat.

Është veçanërisht i rëndësishëm roli proaktiv i këtij autoriteti gjatë njoftimit të qytetarëve për ekzistimin dhe kompetencat e tyre që të pranojnë iniciativa nga qytetarët dhe nga personat juridikë.

Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi aplikacion mobil për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor. Aplikacionin mund ta shkarkoni FALAS në Google Play Store dhe në Apple Store me emrin "Судски совет под лупа". Këtu do t'i gjeni të gjitha informacionet rrjedhëse dhe raportet tremujore të hartuara në kuadër të Projektit "Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM".

